

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 89/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje **Nuhi Paçarizi –Kryetar, Tefik Sylejmani-Referues dhe Goran Milekovič**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 89/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **“INFO COM”** me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqësoj **Betim Haxha**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në seancën e dt. 17 maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik **“INFO COM”** me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).
- II. **Vërtetohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT, njoftim për dhënie të kontratës për aktivitetin të prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, si i bazuar.
- III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.
- V. Operatorit ekonomik ankues **“INFO COM”** me seli Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.
- VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), më dt. 09 shkurt 2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 13 (trembëdhjetë) operator ekonomik. Sipas komisionit vlerësues nga 13 (trembëdhjetë) operatorët ekonomik që kanë ofertuar, në aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, 4 (katër) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 9 (nëntë) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më 16 mars 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës .

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 24 mars 2017, operatori ekonomik “INFO COM” me seli Prishtinë, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7, nenit 52, nenit 54, nenit 56, nenit 59, nenit 61 dhe nenit 72 të LPP-së, si dhe nenit 9.2 të dosje së tenderit.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 13 prill 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues, me datën 24 prill 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, sqaron se qëndro pretendimi i operatorit ekonomik ankues, sepse autoriteti kontraktues ka ngarkuar Letrën standarde për tenderuesin/ kandidatin e eliminuar, për operatorët ekonomik të eliminuar (dt. 16.03.2017), duke dhënë arsyet e eliminimit të operatoreve ekonomik të cilëve ju ka adresuar letra standarde në fjalë. Mirëpo, OSHP-ja, me dt. 03 prill 2017, ka marrë përgjigje nga kompania “Infodom” Kroaci ((kontraktori për E-prokurimit), ku thuhet ndër të tjera: Nuk ka të dhëna në sistem se shfrytëzuesi ka dorëzuar dokumentet te operatorët ekonomik. Shfrytëzuesi vetëm ka ngarkuar dokumentet. Për secilin prej atyre dokumenteve, nëse e hapin listën nën “Dërgimi i dokumenteve”, lisat është e zbrazët.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “AK i **Ministrit** së Arsimit ka bere shkelje te nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, pasi AK duhet te sigurojnë dëshmitë për kualifikime minimale dhe te specifikuar ne dosjen e tenderit dhe Kompania rekomanduar për kontrate ” **N.T.SH NORD**” nuk ka plotësuar referencat me çmime”, bazuar në shkresat e lëndës ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në FTD, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuar: “Lista e shërbimeve, furnizimeve te realizuara ne tre vitet e fundit(2013-2014-2015), produktet e përfshira, shumat e kontratave, data dhe pranuesi, kopja e referencave për pajisje”, mirëpo operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në këtë aktivitet të prokurimit ka ofertuar në konzercium me OE “RILINDJA” Skenderaj, ku anëtar i konzerciumit OE “RILINDJA” Skenderaj konfrom kërkesë së lartë cekur ka ofruar si dëshmi: Listën e furnizimeve të realizuar në 3 vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), bashkangjitur kontrata dhe referencat me çmime.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 71 paragrafi 4 të LPP-së, sqaron: “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”, andaj operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës konform nenit 69 paragrafi 8 të LPP-së, mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjerë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet : “AK i **Ministrit** së Arsimit ka bere shkelje te nenit 61 te LPP-se dhe rregullores Udhëzim Administrativ Nr. 3/2015, pasi duhet te na dërgoj njoftimin mbi arsyetimin te çmimit Jo normalisht te ulet. Ne si Kompani kishim jep një Arsyetim për çmimet Jo normalisht te ulet dhe duhet ti men r parasysh shpjegimet e dorëzuara nga Tenderuesi shih nenin 61.2 dhe nenin 61.3 dhe 61.4. ”, ekspertja shqyrtues bazuar në nenin 61 i LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo. Ndërsa, në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankues e ka vlerësuar si ofertë të papërgjegjshëm për faktin se operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi ashtu siç janë kërkuar në njoftimin për informata shtesë të dt. 24.02.2017, respektivisht nuk ka ofruar: Një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, ekspertja shqyrtues sqaron është përgjegjësi dhe drejtë e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarim me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre apo jo, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Bazuar në atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si pjesërisht të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës të dt. 16 mars 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresë me shkrim të dt. 25 prill 2017, e njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 24 prill 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues i dt. 24 prill 2017, si dhe parashtresën e operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues "INFO COM" z. Haxha, gjatë seancës dëgjimore, deklaroj: ne disa konstatime të ekspertit jemi pajtuar, mirëpo nuk jemi pajtuar në konstatimet se eksperti nuk ka cek çështjen për njoftimin për dhënie për konzorcium, nuk është njoftuar operatori ekonomik. Ndërsa, në njoftimin e KRPP-së thuhet se duhet të njoftohet operatori ekonomik përmes platformës ose emailit. Ne nuk jemi njoftuar nga AK-MASHT, me kohë për eliminimin tonë si dhe me rekomandimet e tyre, një gjë të tillë e ka konstatuar edhe eksperti shqyrtues.

Në vazhdim të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi: ne kemi qenë me çmim më i lirë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, dhe po ashtu kemi dyshime se konzorciumi është futur pas hapjes, pasi ky konzorcium nuk është cek në hapje dhe në njoftim për dhënie të kontratës.. Po ashtu ne kemi qenë operatori ekonomik më i lirë se gjithë operatorët ekonomik tjerë.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues gjatë prezantimit në séance theksoi se autoriteti kontraktues nuk ju ka lejuar qasje në dokumente siç e ka obligim me LPP-në, nenin 10 paragrafi 3 dhe paragrafi 5, dhe se kanë shkuar drejtpërdrejt me kërkesë për rishqyrtim, për shkak të çmimit më të ulët.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues i propozoj panelit shqyrtues të aprovoj ankesën si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktues MASHT, znj. Tafilaj, gjatë seancës dëgjimore, deklaroj: njoftimi për dhënie ka shkuar përmes sistemit elektronik, me dt. 16 mars 2016, ndërsa operatori ekonomik ankues është njoftuar me 15 mars 2017. Operatori ekonomik ankues ka dërguar një kërkesë për rishqyrtim, mirëpo e kemi konsideruar të pa afatshme, pasi i njëjti është njoftuar për eliminim me 15 mars 2017.

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktues në vazhdim të prezantimit sqaroi, operatori ekonomik ankues po ashtu është vlerësuar si operator ekonomik me çmim abnormalisht të ulët, ku ka pozicione që ka ofruar toner me çmim 2.00€. Pas ankesës në OSHP kemi pranuar raportin e ekspertizës ku jemi pajtuar me mendimin dhe rekomandimin e ekspertit.

Sa i përket konzorciumit, përfaqësuesja e autoritetit kontraktues deklaroj se nuk është futur asnjë ofertë pas hapjes, dhe OE "Nord" është në konzorcium me OE "Rilindja".

Ekspertja shqyrtues e prokurimit znj. Bullatovci deklaroj: fillimisht sa i përket eliminimit të operatorit ekonomik ankues, OSHP ka kërkuar në KRPP verifikim se a ka shkuar letra standard për eliminim të operatorit ekonomik ankues apo jo me datë 15 mars 2017. Me datë 03 prill 2017, është marr përgjigje nga kompania implementuese “Infodom” Kroaci si kontaktues i E Prokurimit, se tek shfrytëzuesi nuk ka arritur shkresa në fjalë.

Pretendimin e operatorit ekonomik ankues për shkelje nenit 69 të LPP-së, kam sqaruar përmes konstatimit Nr. 3, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në konzorcium me OE “Rilindja”, ku anëtari i konzerciumit OE “Rilindja” ka ofruar konform kërkesës së autoritetit kontraktues listën e furnizimeve tri vitet e fundit 2013-2015, ku i ka bashkangjitur kontratat dh referencat me çmime.

Bazua në nenin 71 të LPP-së, dihet se nëse një operator ekonomik oferton si grup i operatorëve ekonomik, operatorët ekonomik në mënyrë individuale janë të obliguar të plotësojnë vetëm kërkesat e nenit 65 të LPP, ndërsa çdo kërkesë e autoritetit kontraktues në FTD sipas nenit 66.2, nenit 68 dhe nenit 69 të LPP-së, duhet të plotësohen nga grupi si tërësi, që në rastin konkret OE “Rilindja” e plotëson OE “Nord”.

Gjatë diskutimit në seancë u tha që autoriteti kontraktues ka bërë shkelje nenit 10, në këtë fakt këtë pretendim ankimor nuk e kam shqyrtuar, pasi nuk ka qenë pretendim ankimorë në ankesë të operatorit ekonomik ankues të parashtruar me datë 29 mars 2017. Çështja tjetër konzorciumit, as ky nuk ka qenë pretendim ankimorë në ankesë datës 29.03.2017, mirëpo me qëllim të vërtetimit të gjendjes kam bërë kopje të marrëveshjes së OE “Nord” dhe OE “Rilindja”.

Sa i përket çmimit, ekspertja shqyrtues theksoi se është e drejtë ekskluzive e autoritetit kontraktues për vlerësim të çmimit jo normalisht të ulët, dhe siç ka potencuar autoriteti kontraktues ka pozicione ku për toner është ofruar çmim 2 euro.

Ne fund të prezantimit ekspertja shqyrtues shtoi e qëndroj pranë raportit të ekspertizës së të datës 24 prill 2017.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, konstatoj se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se autoriteti kontraktues ka ngarkuar Letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar në sistem, mirëpo letra standarde mbi tenderuesin e eliminuar operatore ekonomik ankues nuk e ka pranuar. Këtë e ka konfirmuar, me dt. 03 prill 2017, kompania “Infodom” Kroaci ((kontraktori për E-prokurimit),.

Paneli shqyrtues bazuar në nenin 54 të LPP-së, konstaton se autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar që menjëher ta njoftoj me shkrim operatorin ekonomik ankues si tenderuesi i eliminuar, duke cekur edhe arsyet e eliminimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendim i operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në këtë aktivitet të prokurimit ka ofertuar në konzorcium me OE “RILINDJA” Skenderaj, ku anëtari i konzerciumit OE “RILINDJA” Skenderaj konform kërkesës së specifikuar në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, ka ofruar si dëshmi: Listën e furnizimeve të realizuar në 3 vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), bashkangjitur kontrata dhe referencat me çmime.

Paneli shqyrtues bazuar ne nenin 71 paragrafi 4 të LPP-së, sqaron: “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”, andaj operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës konform nenit 69 paragrafi 8 të LPP-së, mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjerë.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo, mirëpo në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankues e ka vlerësuar si ofertë të papërgjegjshëm për faktin se operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi ashtu siç janë kërkuar në njoftimin për informata shtesë të dt. 24.02.2017, respektivisht nuk ka ofruar: *Një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët.*

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë seancës dëgjimore verifikoj çmimet e ofruara të operatorit ekonomik ankues për pozicionet nr. 37, nr. 38, nr. 39 dhe nr. 40, dhe konstatoj se operatori ekonomik ankues për këto pozicione ka ofruar çmimin 2.00 € për toner.

Paneli shqyrtues konstatoj se çmimet e ofruara nga operatori ekonomik ankues për pozicionet e lartë cekura janë çmime të cilat nuk janë në harmoni me çmime e tregut dhe që dëmtojnë konkurrencën e hapur në treg.


Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertës shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtrës së operatorit ekonomik ankues, si dhe duke pasur parasysh faktin se *çmimet e ofruara në listën e çmimeve për pozicionin nr. 37, nr. 38, nr. 39 dhe nr. 40, nga operatori ekonomik ankues janë çmime të cilat nuk janë në harmoni me çmime e tregut dhe që dëmtojnë konkurrencën e hapur në treg,* konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi / Panelit Shoqytues



Nuhi Pacarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "INFO COM" Prishtinë

1x1 ekzemplar - AK- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së